



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2021 merr këtë

### **V E N D I M**

#### **PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E SKULPTURËS “USHTARI I PANJOHUR”**

- I. MIRATOHET** Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e skulpturës “Ushtar i panjohur”.
- II.** Lokacioni për vendosjen e kësaj skulpture, është propozuar të jetë në hapsirën afër parkingut në lagjen “Dardania”, përkatësisht në parcelën kadastrale, nr. 07481-0, ZK Prishtinë, në pronësi - pronë shoqërore, KK Prishtinë.
- III.** Ky vendim paraqet bazë për caktimin e lokacionit të këtij monumenti.
- IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-353/01-185449/21, më 03.09.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta



## A R S Y E T I M

### I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e skulpturës “Ushtari i panjohur”

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën, nr. 04-353/01-174972/21, dt. 24.08.2021, të Drejtorisë së Kulturës të Komunës së Prishtinës, për vendosjen e skulpturës “Ushtari i panjohur”, në kuadër të aktivitetit “Art në hapësira publike”, në lagjen “Dardania”.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, sipas kërkesës së lartëcekur nga Drejtoria e Kulturës, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e skulpturës, e cili gjendet në kuadër të Planit rregullues “Dardania”, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01 nr. 110-710, dt. 05.06.2009, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për garazhe nëntokësore – gjelbërim dhe lojëra. Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale, nr. 07481-0, ZK Prishtinë, në pronësi - pronë shoqërore, KK Prishtinë.


Skulptura në fjalë është propozuar të vendoset në hapësirën afër parkingut, në kuadër të parcelës nr. 07481-0, sipas propozimit të bashkëngjitur, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit, sipas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës të Komunës së Prishtinës, duke përcaktuar saktë dimensionin e bazamentit.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset skulptura është sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes së skulpturës duhet t’i kushtohet kujdes i veçantë ambientit, drurëve, dhe propozohet që skulptura bazuar në hapësirën përreth të vendoset në madhësi, formë dhe material të përcaktuar sipas kërkesës së parashtruar, duke përcaktuar saktë dimensionin e bazamentit të skulpturës, si dhe verifikimin paraprak në terren, në mënyrë që të mos ketë ndonjë pengesë.

#### **Bashkëngjitur:**

- Ortofoto e lokacionit, sipas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës;
- Skica e skulpturës “Ushtari i panjohur”.

Lokacioni i propozuar nga Drejtoria e Kulturës për vendosjen e skulpturës;



Skica e lokacionit e propozuar nga Drejtoria e Kulturës



Skica e skulpturës sipas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës